

A Numri i lëndës: 2022:253016

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05682486

Pml.nr.236/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Valdete Daka dhe Rasim Rasimi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të dënuarve D., I. dhe R. D., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje kanosja nga neni 181 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës së përbashkët për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarve, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë – Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.491/2022 të datës 14.7.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PAI.nr.1097/2023, të datës 18.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 24.4.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e përbashkët për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarve D., I. dhe R. D., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë – Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.491/2022 të datës 14.7.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PAI.nr.1097/2023, të datës 18.12.2023.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë - Dega në Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.491/2022 të datës 14.7.2023, të dënuarit D. D., I. D. dhe R. D. i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK dhe u është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej treqind euro (300€), të cilin të dënuarit detyrohen ta paguajnë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë. Nëse të dënuarit nuk e paguajnë shumën e përcaktuar, atëherë ky dënim me gjobë do t'iu zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo njëzet (20) € të pa paguara do tu llogaritet një (1) ditë burgim.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PAI.nr.1097/2023, e datës 8.12.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit D. D., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë të përbashkët për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë paraqitur të dënuarit D. I. dhe R. D., për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.131/2024 e datës 16.4.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarve të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPP dhe pasi i vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa është e pabazuar.

Të dënuarit, në kërkesën e përbashkët për mbrojtjen e ligjshmërisë theksojnë se të dy aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me vërtetimin gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale, ngase të dënuarit janë të pafajshëm sa i përket kësaj vepre penale, ku të njëjtit do të duhej të ishin në rolin e viktimave, nga se e gjithë ngjarja ka ndodhur e inskenuar nga ana kinse e të dëmtuarit B. D. . Ardha e tij në fshatin R. ka qenë me qëllime të liga dhe të këqija. E gjithë ngjarja ka ndodhur në shtëpinë e të dënuarve, i njëjti duke u munduar t'i incizojë gjendjen, e cila është marrë si provë e besueshme nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë ku theksohet se si provë të një rëndësie të veçantë, të cilës gjykata i kushtoi rëndësi me rastin e marrjes së vendimit është edhe dëgjimi i audio incizimit – CD dhe bisedës së zhvilluar në vendin e ngjarjes, në mes të dëmtuarit dhe të pandehurve, nga e cila vërtetohet fakti se të pandehurit dëgjohen duke biseduar me tone të larta me të dëmtuarin edhe pse nga zërat që dëgjohen nuk dihet se cili nga ata i është drejtuar të dëmtuarit me fjalë kanosëse se nuk do tu hypësh këmbëve tua. Gjyqtari e shpallë provë të pranueshme dhe ia falë besimin, dhe se incizimi i tjetrit pa dëshirën e tij është vepre penale dhe kjo provë është provë e papranueshme dhe jo në rrugë ligjore. Po ashtu edhe ardhja e familjarëve dhe e fqinjëve ishte jo me qëllim që të shkaktohen telashe por me qëllim që të mos vije deri te ndonjë ngatërresë ne mes tyre, këtu kemi të bëjmë me një mosmarrëveshje pronësore dhe një inskenim të situatës nga pala kinse e dëmtuar, dhe se i njëjti këtë e ka bërë për përfitimet e tija ligjore duke marrë parasysh moshën relativisht të shtyrë të të pandehurve dhe duke ua njohur atyre temperamentin e tyre, i njëjti ka inskenuar një situatë të tillë vetëm për përfitime ligjore. Të dënuarit kanë qenë viktimë e rastit dhe se provokimi i palës së dëmtuar është i papranueshëm dhe i pa tolerueshëm sepse faktet në këtë rast flasin vetë, por që në mënyrë të gabuar janë shtjelluar, dhe se përveç dëmit ekonomik i cili u kanoset me këto vendime, dëmi moral është shumë i lartë pasi që të njëjtit për herë të parë ndodhen në një situatë të tillë dhe të shpallen fajtorë në këso lloj mënyre, pa prova konkrete dhe me një inskenim të tillë është e pa pranueshme.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit është shkelur neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 par. 1 të KEDNJ, që ka të bëjë me mungesën e arsytimit adekuat të vendimit gjyqësorë. Më tej, në kërkesë zërthehen këto nene si dhe neni 10 i Deklaratës së Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut e vitit 1948, ku theksi kryesor bie në qëllimin e ligjvënësit që vendimet e kundërshtuara arsytimi i tillë i bën të paligjshme dhe si të tilla përmbajnë shkelje absolute e që çojnë në anulimin e aktgjykimeve të kundërshtuara.

Fillimisht duhet theksuar se konform nenit 432 par. 2 të KPP, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike.

Nuk janë të bazuara pretendimet e të dënuarve se dëgjimi i audio incizimit – CD dhe bisedës së zhvilluar në vendin e ngjarjes është provë e papranueshme, ngase gjykata drejtë ka vepruar kur e ka pranuar këtë provë materiale nga e cila provë e marrë drejtpërdrejtë në vendin e ngjarjes dhe e dorëzuar menjëherë pas rastit në polici, e me qëllim të zbulimit të veprës penale dhe se së bashku edhe me provat tjera ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në aktgjykimin e kundërshtuar. Po ashtu të dënuarit kanë pohuar se zërat dhe përmbajtja e tërë bisedës së zhvilluar ka qenë nga vendi i ngjarjes.

Nuk qëndron as pretendimi se është shkelur e drejta për një proces të rregullt respektivisht e drejta për një vendim gjyqësor të arsytuar, i garantuar me kushtetutë dhe konventa, ngase të dy gjykatat, si ajo e shkallës së parë ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë, në aktgjykimet e tyre kanë dhënë arsye të mjaftueshme dhe analizë të mjaftueshme të provave veç e veç, duke përfshirë këtu edhe CD, dhe mbrojtjes së të dënuarve, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo Gjykatë.

Pra, pasi që nga përmbajtja e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë rezulton se aktgjykimet kundërshtohen edhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, bazuar në nenin 432 par. 2 të KPP, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Andaj, nga arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 437 të KPP është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.236/2024, më datë 24.4.2024

Bashkëpunëtorja profesionale,
Qefsere Berisha

Kryetare e kolegjit,
Mejreme Memaj